

Akt Themelimi

I shoqërisë tregtare “NUVOLA” shpk

Mbeshtetur në Kushtetuten dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.7512 datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nënshkrimin dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit”, të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për shoqëritë tregtare” dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare”, me vullnetin e tyre të lire, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, në ortakë krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar ” **NUVOLA** ” **SH.P.K.** me akt themelimi si vijon:

Formulimi

Neni 1

Sot, me datë 31/08/2018, formohet shoqëria tregtare private e quajtur “**NUVOLA**” SH.P.K. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa deget që mund të krijojnë do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.

Shoqëria do të ushtroje veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

Selia e Shoqërisë

Neni 2

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:

Kavaje, Lagjia nr.2, e ndodhur në pasurinë nr. 4/368-N16, zona kadastrale nr.8551

Objektivi i Veprimtarisë

Neni 3

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Prodhim dhe shërbime të tjera të gjëra të përdorueshme dhe llojeve të tjera të tregtisë së tyre me shumicë dhe pakicë, import - eksport si dhe asistencë teknike për proceset e ndryshme të këtyre punimeve të specializuara. Prodhim dhe tregtim me shumicë të polipropilenit dhe import -eksportin e tyre. Prodhim, punim, tregtim me shumicë dhe punime për llogaritë të tregtisë të dyshmeve, divaneve, sustave të divaneve dhe krevateve etj. Import - eksport, prodhim dhe tregtim mobiljesh.

Kohegjatja e Shoqërisë

Neni 4

Kohegjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloji shkak.

Kapitali i Shoqërisë

Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 lekë (njëqind mijë) Lekë.

2. Ortaku: **Todi Buli** zotëues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

3. Ortaku: **Nursen Metuli** zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 (pesedhete mijë) lekë, që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Drejtimi i Shoqërise

Neni 6

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj Jurgen BARDHI, i cili do të jetë perfaqësuesit i Shoqërise në marrëdhënie me të tretet dhe kanë kompetenca të plota në drejtimin e saj.

Cdo kontratë do të kryhet prej tyre dhe në rast mungese nga një perfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

Neni 7

Te ardhurat neto të shoqërise i takojnë ortakëve.

Neni 8

Ortakët kanë të drejtë të emerojnë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale.

Ka të drejtë të caktojë financiare, likuidator për problemet e shoqërise si dhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë.

Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Neni 10

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Krijimin e Shoqërive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

Neni 12

Akti i themelimit u perpilua në 2 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërise "NUVOLA" SH.P.K.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët.

ORTAKET

Todi Buli



Nursen Metuli

